

PROGRAMI

BASHKË

**ME PËR GJEGJËSI DHE
PËRKUSHTIM**

Kandidati për kryetar të LSDM-së

Dimitar Kovaçevski

LSDM

ADRESIMI PËR TË GJITHË SOCIALDEMOKRATËT

Të nderuar socialdemokratë, miq,

Po ju drejtohem për të paraqitur vizionin dhe programin tim, me çfarë edhe kërkoj besimin dhe mbështetjen tuaj për kryetar të LSDM-së.

Në kohën e sfidave serioze me të cilat përballet shoqëria jonë dhe të gjithë qytetarët tanë, por edhe në kohën kur LSDM-ja dhe e majta në përgjithësi ka nevojë për vendime të shpejta dhe diskutime cilësore, vendime dhe përforcime, është përgjegjësi të veprohet dhe të ndërmerren hapa vendimtare.

Prandaj po kandidoj për kryetar partie. Marrjen e përgjegjësisë në këto momente, pas dorëheqjes së kryetarit Zaev, e konsideroj të nevojshme, si dhe motivin tim për sukses të përbashkët e shoh si mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të LSDM-së, por edhe për të ardhmen e shtetit.

Para anëtarësisë sonë dhe të gjithë qytetarëve tanë qëndrojnë shumë sfida të cilat duhet trajtuar. Pandemia ende vazhdon, është paralajmëruar krizë energjetike, rritje e mundshme e çmimeve, pengesa në rrugën evropiane, rreziqe dhe kërcënime reale nga të cilat vendi mund të devijojë rrugën evropiane dhe reformuese, joefikasitetin në zbatimin e politikave dhe masave, si dhe të tjera.

Ne kemi nevojë për një përgjigje të shpejtë për çdo fushë, për çdo pyetje, një zgjidhje të përshtatshme. Përgjegjësi dhe detyra të qarta që duhet të ndërmerren në parti, si dhe shërbime të shpejta dhe efikase ndaj qytetarëve nga ana e shtetit.

Kemi nevojë për motivim, aktivizim dhe angazhim të të gjithë anëtarësisë së LSDM-së, por edhe të të gjithë qytetarëve, aksion për të gjithë ato që janë gati të ngrihen dhe të luftojnë për rrugën përpara, për dinjitet, drejtësi, solidaritet, barazi, interes publik, për standardet evropiane, për demokracinë sociale, për popullin tonë, por mbi të gjitha për të ardhmen e atdheut si shoqëri e të gjithëve. Rreth bashkimit, rreth asaj çfarë kemi të përbashkët, për të mirën e përbashkët dhe kombëtare, kundër ndasive.

Ne kemi nevojë për një **lëvizje qytetare** rreth asaj çka është çelës - rreth progresit. Ne jemi më të thirrurit, socialdemokratët, të majtët, socialistët, liberalët, demokratët, të gjelbërtit, të gjithë së bashku. Të gjithë ne nga qendra në të majtë, së pari le të bashkohemi rreth synimeve të përbashkëta dhe të qarta, siç është rruga evropiane dhe reformuese, të tregojmë rezultate të përbashkëta, e më pas t'i shtrijmë dorën të gjithëve nga qendra në të djathtë sepse Maqedonia e Veriut është një ide e madhe dhe ne të gjithë duhet të kontribuojmë në përparimin e saj.

Kjo është gjëja e parë kryesore për të cilën zotohem para jush.

Për ta forcuar lëvizjen tonë, do të fillojmë që na shtëpia, nga radhët tona dhe më pas jashtë. Me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, sindikatat, punëtorët, fermerët, profesorët, mësuesit, të rinjtë, studentët dhe kjo të ndikojë për ndryshime pozitive edhe tek subjektet tjera politike.

TË GJITHË NE SË BASHKU!

Sepse ne me qytetarët progresiv e demokratë në vetëm pak vite e kemi lëvizur vendin në drejtimin e duhur. Nuk duhet sërish të lejojmë kthim mbas, në pasiguri. Përgjegjësia jonë është të bëjmë gjithçka që vendi të vazhdojë përpara.

Secili prej nesh e di se nevojiten ndryshime në mënyrën se si menaxhohen institucionet, në mënyrën se si punohet, në marrëdhëniet, në përgjegjësit, qasjen ndaj qytetarëve dhe më e rëndësishmja, në efikasitetin e operacioneve dhe zgjidhjen e sistemit dhe problemeve të përditshme të qytetarëve.

Sa më efektive të zbatohen politikat socialdemokrate, aq më shumë progres dhe më i sigurtë do të jetë vendi, aq më të sigurtë, të qetë, të kënaqur do të jenë qytetarët.

Prandaj edhe po kërkoj besimin tuaj. Jo për ndryshime vetëm për hir të ndryshimit. Jo për zëvendësime dhe trashëgimtarë. LSDM-ja është parti e madhe dhe ka guxuar para raundit të dytë të zgjedhjeve lokale të pranojë se gabimet shihen dhe ndryshimet janë të pashmangshme.

Nuk po qëndroj përballë jush për të dhënë ndryshime “bombastike” që lidhen me emra dhe mbiemra, por ndryshime drastike në lidhje me mënyrën e punës dhe funksionimin. Përforcim i asaj që ishte e mirë dhe korrigjim serioz i gjithçkaje që nuk ishte dhe nuk funksionoi. Të krijojmë një sistem efikas që i shërben qytetarëve në një mënyrë tjetër, mënyrë po aq e shpejtë dhe po aq cilësore për të gjithë, në të cilën ka një vend për këdo që dëshiron të përshtatet.

Besimin tuaj e kërkoj për **PUNË EKIPORE, ME RREGULLA DHE PËRGJEGJËSI TË QARTA, TË PËRCAKTUARA QARTË PËR TË NXITUR PËR MË MIRË** secilin qytetar. Ky është zotimi im i dytë.

Siç thashë, pa zëvendësime dhe pa trashëgimtarë. Përmes konsultimeve, jam duke zhvilluar një koncept të ri të udhëheqjes që nënkupton përgjegjësi të përbashkëta e synime të përcaktuara, dhe kjo është për të mirën e popullit tonë, të atdheut tonë.

LSDM-ja ka një anëtarësi të madhe dhe të fortë, potencial të madh në partinë që është në pritje për t'u vënë në funksion. Është koha që potenciali i LSDM-së të marrë një shans, të dalë në pah. Së bashku. Së bashku le të bëjmë një hap përpara, përpjekjet tona janë shumë të mëdha, kurse vendi ynë është i vogël për të përjashtuar cilindo qoftë.

Prandaj do të përfshijmë dhe ndajmë përgjegjësitë, brenda dhe jashtë partisë, do të kërkojmë mbështetje nga aleatët tanë, nga demokratët, nga socialistët, nga të rinjtë, gratë, burrat, të rriturit, profesorët dhe shkenctarët, nga puntorët, nga fermerët dhe fqinjët, nga të gjithë ata që ia mendojnë të mirën atdheut.

Po, mundemi. **Me një plan të qartë, me zgjidhje, me një sistem që krijon dhe realizon.**

Kam respekt të thellë për sukseset që kemi arritur në udhëheqjen tonë me mikun Zoran Zaev, si kryetar i LSDM-së dhe si kryeministër. Koha do të tregojë atë që shumë njerëz sot nuk munden ose nuk duan ta shohin. Është bërë shumë për shtetin tonë, në segmente të ndryshme janë realizuar interesat strategjike kombëtare, jetojmë në një shoqëri të lirë dhe demokratike, e paratë më në fund filluan të shkojnë tek qytetarët.

Unë, Dimitar Kovaçevski, nuk e shoh veten si trashëgimtar dhe as nuk pres nga dikush të trashëgoj dikë. **Jam gati të drejtoj me një koncept, plan dhe vizion të qartë.**

Tri shtylla kyçe mbi të cilat mbështetet vizioni im, që përcakton rrugën përgjatë të cilës do ta drejtoj dhe për të cilën kërkoj mbështetjen tuaj, dhe ato janë:

1. VIZIONI SOCIAL-DEMOKRAT

Një politikë e bazuar në vlera të qarta socialdemokrate, nga të cilat burojnë parimet dhe rezultatet;

2. EKONOMIA NË RRITJE

Rritje stabile dhe të shpejtë të standardit ekonomik të qytetarëve tanë, si investimi ynë për një jetë më të mirë të qytetarëve;

3. MENAXHIM EFIKAS DHE ME PËRGJEGJËSI

Njohuri, efikasitet dhe një mundësi e drejtë si një sistem i ri që do të krijojë dhe do të realizojë gjithçka që kemi premtuar, planifikuar, dëshiruar për të mirën e vendit dhe popullit tonë.

Kërkoj mbështetjen tuaj për të filluar menjëherë me **aktivizmin tonë të ri**, me kontributin tuaj për secilën nga këto tri shtylla kyçe, po aq të rëndësishme dhe të nevojshme.

Ne mund të ndajmë dhe të ndërtojmë një sistem vlerash vetëm nëse ai shërben si interes publik, si e mirë e përbashkët.

Mund të sigurojmë një jetë më të mirë për qytetarët, me paga më të larta, të ardhura mujore, por cilësia e jetës lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e shërbimeve në arsim, shëndetësi, shërbime sociale, rend dhe siguri, mjedis jetësor i shëndetshëm.

Ne mund të krijojmë një sistem efektiv vetëm nëse ligjet, rregullat zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë. Pa drejtësi, qasje të barabartë dhe efikasitet në shpërndarje nuk ka drejtësi. Qytetari ynë, njeriu ynë, kërkon drejtësi dhe paanësi sepse e di që të ndershmit poshtërohen dhe të pandershmit glorifikohen, sepse qytetarit i pengon kur sheh se ai që u bindet rregullave konsiderohet naiv, kurse ai që nuk u bindet shihet si i ditur. Prandaj drejtësia është në interes të opinionit publik.

Korrupsioni në tri dekadat e fundit ka depërtuar thellë në çdo pore të shoqërisë. Ne nuk duhet të pranojmë që korrupsioni dhe ryshfeti janë pjesë e kulturës sonë, ne duhet ta ndryshojmë atë, së bashku. **Theks të veçantë në efikasitetin e institucioneve vendosëm luftën kundër korrupsionit.** Disa procese kanë nisur, por qytetarët thonë se nuk mjafton dhe prandaj do të inicioj forcimin e masave aktuale, por edhe masa të reja të zbatueshme kundër korrupsionit.

Demokracia në thelb nënkupton **sundimin e ligjit, rregullave, rregulloreve dhe marrjen e përgjegjësisë kur të njejtat nuk respektohen.** Shoqëritë demokratike janë më të suksesshme kur një sistem i tillë zbatohet në mënyrë efektive. Ky do të jetë fokusi im, e nëse e marr besimin tuaj ky do të jetë fokusi i LSDM-së, planet, masat, zbatimi efikas, matja e rezultateve dhe korrigjimet për përmirësim të gjendjes.

Kam qëndrim, zero tolerancë ndaj korrupsionit dhe kërkoj kryerjen e detyrave në përputhje me të gjitha procedurat ligjore dhe rregullativat. Nëse marr mbështetjen tuaj për kryetar, mbaj përgjegjësinë se do të kërkoj që këto parime të vihen në praktikë, të zbatohen në radhë të parë brenda partisë, por edhe në Qeveri dhe institucione, pa marrë parasysh kush është kryeministër dhe kush janë liderët e tjerë - nuk ka kompromis në parim. Korrupsioni duhet të sanksionohet në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi.

Nga njëra anë janë ndryshimet sistematike, nëpërmjet qeverisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe në institucionet përkatëse, në avancimin e sistemit gjyqësor, por nga ana tjetër ka edhe organe të pavarura gjyqësore, sepse gjyqësori është autoritet më vete, ekziston prokuroria e cila jep përgjegjësi para Kuvendit.

Korrupsioni e shkatërron të gjithë shoqërinë, por edhe krijon një imazh të keq për vendin dhe ndikon drejtpërdrejt në motivimin e qytetarëve dhe besimin e tyre në institucionet, jo vetëm në aspektin e shpërdorimit të pozitës, por edhe në drejtim të uljes së konkurrencës në ekonomi, në drejtim të uljes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

Gjyqësori dhe prokuroria duhet të jenë të pavarura, por edhe ato duhet të rrisin efikasitetin. Pavarësinë dhe autonominë e tyre që nënkupton edhe përgjegjësinë që kanë.

Mund të kemi zgjidhje të panumërta ekologjike, rregullore, mirëpo ne na duhet përgjegjësi ekologjike dhe ndikim i drejtpërdrejtë në sjelljen e institucioneve tona ndaj mjedisit të pastër jetësor që në fund të fundit nënkupton shëndet më të mirë për njeriun.

Prandaj cilësinë e shërbimeve, drejtësinë dhe ekologjinë e vendosim në krye të interesit publik dhe aktivizmi ynë politik e shoqëror do të fokusohet në po këto tema thelbësore.

Të nderuara shoqe dhe shokë,

Të ashtuquajturat “politika të mëdha” po i lë në fund të adresimit tim për ju. Jo sepse mendoj që ato janë më pak të rëndësishme, përkundrazi, ato janë strategjike dhe jashtëzakonisht të vlefshme, mbi to qëndron e ardhmja e ndritur e shoqërisë sonë.

Maqedonia e Veriut duhet të vazhdojë në këtë rrugë tashmë të shtruar euroatlantike, si shtet i lirë dhe demokratik, anëtar i NATO-s, anëtar i ardhshëm i BE-së. LSDM-ja është garancë për këtë.

Prioritetet strategjike të përcaktuara që nga pavarësia janë prioritete strategjike të LSDM-së, por edhe të çdo qytetari të lirë të vendit tonë.

Pikërisht partia shtetformuese e LSDM-së ndër vite ka luftuar në çdo mënyrë të mundshme, dhe në katër vitet e fundit bëri më së shumti dhe arriti ta realizojë plotësisht anëtarësimin në NATO dhe të plotësoj të gjitha kushtet për fillimin e negociatave me BE-në.

Ky sukses së bashku me kthimin e lirisë dhe demokracisë, vendosjen e konceptit të një shoqërie për të gjithë dhe kthimi i parave tek qytetarët janë sukses historik i LSDM-së së bashku me forcat progresive demokratike dhe qytetarët, përfitime të qëndrueshme për vendin tonë. Këtë askush nuk mund ta marrë apo ta mohojë, e për këtë meritore janë edhe të gjithë qytetarët që e mbështetën këtë koncept.

Koncepti qytetar i LSDM-së, një shoqëri për të gjithë, në të cilën i gjithë populli ynë, pa dallime, qofshin ata maqedonas, shqiptarë, turq, serbë, romë, vllahë, boshnjakë apo ndonjë tjetër, nuk do të lejojmë që ky koncept të ndërpritet.

Marrëveshja e Prespës, Marrëveshja e fqinjësisë së mirë dhe Marrëveshja e Ohrit janë garantues të stabilitetit dhe të ardhmes së vendit.

Besoj thellë se përmes shtyllave që përmenda, vlerave, efikasitetit, përmirësimit të cilësisë së jetës së njerëzve dhe aktivizmit të ri politik në baza të interesit publik dhe drejtësisë, sukseseve historike, rrugës së gjurmuar euroatlantike, mund ta sigurojmë dhe përshpejtojmë lëvizjen e shtetit përpara.

Unë, të gjithë ne, nuk duhet dhe nuk do ta lejojmë të devijojmë nga rruga për të cilën vështirë luftuam.

Ajo që populli sheh, ndjenë dhe qartë na dha si mesazh në zgjedhjet e fundit lokale, nuk ka lidhje me drejtimin e shtetit, me vendosjen strategjike dhe me konceptin qytetar. Shumica e qytetarëve, partive demokratike, shoqatave, aktivistëve, popullit tonë, po na thonë qartë se duan ta mbajnë këtë drejtim pro-evropian, rrugën demokratike dhe euroatlantike.

Por **populli ynë ka vërejtje serioze dhe të bazuara në efektivitetin** e zbatimit të disa reformave dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve, te shpejtësia me të cilën zbatohen ndryshimet, në sistemin e ngadaltë kur është fjala për drejtësi, llogaridhënie, sanksionimin e korrupsionit, me një fjalë **veprimin e ngadalshëm dhe selektiv kur është në pyetje interesi publik.**

E gjithë kjo na çon në ndryshimet e nevojshme që duhet të bëjmë brenda për tua dorëzuar qytetarëve. Jo të premtojmë e më pas të punojmë për ato ndryshime, por për t'i bërë ato e pastaj për t'i njoftuar ato.

Kjo do të thotë **t'i përveshim mëngët në shtëpi dhe të punojmë** që sa më shpejt që shteti ynë të shkojë në rrugën e duhur. Me institucione të rregullta, efikase.

Prandaj dhe po kërkoj besimin tuaj, le të bëjmë atë që duhet të bëjmë së bashku, atë çka duhet, çfarë dimë dhe mund të bëjmë. Jo vetëm një njeri, por të gjithë bashkë!

1. VIZIONI SOCIAL- DEMOKRAT

POLITIKA E BAZUAR NË VLERA TË QARTA SOCIAL- DEMOKRATIKE, NGA VIJNË PARIMET E OPERIMIT DHE REZULTATET

Hapat e parë duhet t'i hedhim në shtëpi, tek partia. Nga ana e ideologjisë dhe vlerave mbi të gjitha, e pastaj në mënyrën e aktivizimit partiak, funksionimit dhe veprimit.

Socialdemokrati që punon në një fabrikë tekstili, socialdemokrati që punon në një spital, socialdemokrati që punon në bujqësi ose në një dyqan, në shkollë, kolegji, në një institucion, të gjithë ndajnë po të njëjtat vlera.

Por na mungon drejtimi që së bashku nuk lëviz ideologjikisht, për të prodhuar veprime të përshtatshme politike, për ndryshime në shoqëri.

Me ndryshime brenda partiake, ideologjike dhe vlera do të krijojmë një vijë, rezultante, e cila së bashku do të na çojë në të njëjtin drejtim, me hapa të reja.

Një hap i ri që i veçon gjërat. **Aktivizimi për të mirën e partisë, por në radhë të parë për të mirën e shoqërisë**, interesin publik. LSDM-ja ekziston për qytetarët.

Jo çfarë mund të bëhet për mua, por çfarë mund të bëhet për të mirën e të gjithëve. Dhe kur bëhet fjalë për të mirën e të gjithëve, sigurisht që do të jetë mirë edhe për mua.

Secili le të shikojë në pasqyrën e tij "Unë" dhe le t'i japë vetes përgjigje: 'Çfarë mund të ndryshoj, çfarë mund të kontribuoj, çfarë mund të ndihmoj?' Ndryshimi fillon me çdo individ dhe vazhdimisht motivon individë të rinj.

Më pak të shihemi mes veti, përballë njëri-tjetrit, më pak të kërkojmë faj tek njëri tjetri, të kërkojmë më shumë nga vetja, të kërkojmë nga të gjithë ne së bashku, të japim më shumë, për të marrë më shumë.

Një hap i ri për hapjen ndaj njerëzve të rinj edhe nga jashtë, mbështetës të mendimit të lirë, të komunikimit të përgjegjshëm, të interesave shtetërore, të drejtësisë sociale, të ambientit më të pastër, për të gjitha temat që na bashkojnë.

Një hap i ri për bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe të hapur me sindikatat, organizatat e shoqërisë civile, aktivistët.

Një hap i ri për të drejta më të gjera ekonomike dhe sociale, për një jetë më të mirë, jo vetëm për qytetarët në nevojë, por për të gjithë, për të gjithë njerëzit tanë.

Barazi para ligjeve dhe normave, mundësi e drejtë për të hyrë në punë, paga të denja dhe më të larta, më shumë kohë për veten, familjen, fëmijët dhe miqësinë. Sepse në atë bazohet

modeli ekonomik socialdemokrat maqedonas. Kur flasim për rritjen e pagës minimale, kur flasim për kujdesin ndaj shtesave të fëmijëve, për hapje të vendeve të punës të paguara mirë, banesa sociale, rritje ekonomike, nënkuptojmë përfitimet thelbësore për çdo person.

Kur kështu do qasemi ndaj anëtarësimit, aktivizmit në LSDM, me vlera dhe ideologji që janë jo vetëm deklarative, por edhe të vërtetuara në thelb me veprime konkrete, atëherë mund të themi po, kemi sukses dhe vazhdojmë më tutje.

Që në fillim dua ta bëj të qartë: ju jeni ekipi im. Çdo anëtar, çdo aktivist. Mënyra ime e funksionimit është **të ndaj detyrat dhe përgjegjësitë**, në ndarje të përbashkët. Jo një person për gjithçka, jo të gjithë për gjithçka. Së bashku, por secili në fushën e vet, në detyrën e vet, konkretisht dhe me plan, me afate dhe pritshmëri të sakta.

Kam bashkëpunuar me të gjithë kryetarët e mëparshëm të LSDM-së, në mënyra të ndryshme dhe në forma të ndryshme që nga fillimi i anëtarësimit tim në LSDM në vitin 1994. Kam qenë anëtar i Klubi Lokal i SDMM në Kumanovë, anëtar i Kryesisë Qendrore të SDMM, kordinator i degës së LSDM-së, anëtar i Bordit Ekzekutiv në Karposh, dy herë anëtar i Bordit Qendror të LSDM-së dhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të partisë në dy raste, anëtar i shtabit zgjedhor në nivel komunal dhe qendror. Kam qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve të LSDM-së kur bashkë me shokët e partisë e ndërtuam atë, pjesë e aktiviteteve për ndryshimin e qeverisë së fundit për rikthimin e lirisë dhe demokratizimin e vendit. Ndoshta nuk kam qenë i pari dhe më i dukshmi, por isha vazhdimisht këtu, për 30 vjet, një socialdemokrat besnik dhe i përkushtuar, në të mirë e në të keqe.

E theksoj këtë sepse besoj se proceset që kalon partia, nuk janë procese të një personi, të disa individëve, por **proceset të përbashkëta** në të cilat të gjithë duhet të inkorporohen për të pasur sukses.

Partia është e hapur për të gjithë, unë jam një person që nuk e mbështes partinë e prapaskenës përfshirë këtu përçarjet dhe rrymat, ajo nuk duhet të na heqë energjinë në punë sepse të gjithë e kemi të njëjtin synim, partia të realizojë premtimet, të punojë dhe të përmirësojë jetën e qytetarëve dhe për këtë duhet të jemi të bashkuar dhe të punojmë shumë. Nuk e kemi luksin të shpenzojmë në fraksione dhe rryma, jemi thirrur nga populli që ta çojmë vendin përpara dhe prandaj kërkoj përgjegjësi nga secili prej nesh për momentin në të cilin ndodhemi.

Prandaj nga unë nuk do të dëgjoni për përçarje dhe rryma, nga unë prisni që të debatoj për politika, zgjidhje dhe dua të dëgjoj mendimin e të gjithëve për të sjellë vendimet më të mira, por më e rëndësishme se kaq do të jetë realizimi i cili duhet të jetë i shpejtë dhe efikas, me fokus në nevojat e qytetarëve.

Do të ushqej demokracinë brendapartiake, por nuk do të lejoj e njejta të keqpërdoret për ndarje të brendshme dhe realizim të interesave personale. Unë hyj me synime të singerta

për ta bërë partinë **efikase, të organizuar dhe të përkushtuar në zgjidhjen dhe punën e problemeve të qytetarëve.**

Kushdo që ndan këto vlera është i mirëpritur.

LSDM-ja gjithmonë ka qenë dhe duhet të mbetet parti bashkuese. Në zgjedhjet lokale kemi lejuar të zvogëlohet potenciali i koalicionit të partisë, por kanë ndodhur edhe ato mosmarrëveshjet e brendshme që rezultuan në ndasi. Qëllimi im kryesor do të jetë të bashkojmë partinë dhe të kapërcejmë dallimet.

LSDM-ja është parti e madhe dhe në të ka shumë njerëz të aftë. Më shumë se tani në parti të gjithë kemi nevojë për njëri-tjetrin. Ne duhet të mësojmë të kritikojmë dobësitë tona dhe të mësojmë prej tyre për të ndryshuar gjërat për të mirë. Gjithashtu të respektojmë atë që është bërë dhe të mos harrojmë se cilat janë sukseset dhe vlerat tona.

LSDM-ja duhet ta përmirësojë komunikimin me anëtarësinë. Nuk mund t'i kërkojmë njerëzit vetëm para zgjedhjeve ose kur partisë i duhet diçka, por vazhdimisht t'i përfshijmë, e kështu zëri i tyre të dëgjohet. Dhe nuk mjafton që ky zë vetëm të dëgjohet, por edhe për të parë se ajo që ata kërkojnë dhe urdhërojnë po zbatohet.

LSDM-ja duhet të vazhdojë me politikat e shkëlqyera sociale, duke ngritur pagën minimale dhe mesatare. Por edhe më shumë duhet të flasim për zgjedhjet e problemeve për të cilat qytetarët flasin me familjen, miqtë dhe që ua vështirësojnë jetën e përditshme. Partia në pushtet duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me problemet e vërteta dhe po të njejtave t'iu përgjigjet.

LSDM-ja është parti shtetformuese dhe përgjegjësia që ka për çdo individ është e madhe dhe e rëndësishme. Nëse socialdemokracia dështon, ne kemi parë se çfarë ka ndodhur më parë, kemi pasur stagnim për 11 vite në kohën e VMRO-DPMNE-së. E kam fjalën për politikat socialdemokrate, vizionin, të ardhmen, aktivizmin e ri dhe vlerat ideologjike nga brenda, me gjithë zemër, sepse besoj në të.

Besoj se mundemi dhe besoj se do t'ia dalim.

LSDM NË PLAN ORGANIZATIV vazhdimisht duhet të bëj ndryshime cilësore, riorganizim strukturor, demokratizim, modernizim dhe profesionalizëm, menaxhim modern, hapje ndaj gjeneratave të reja me njohuri, staf, kompetenca dhe përgjegjësi.

Energji e re në demokracinë brendapartiake

LSDM-ja duhet të vazhdojë të ndryshojë dhe të riorganizohet sipas nevojave të fundit, tendencave dhe pritjeve të anëtarëve dhe qytetarëve. Këto kapacitete demokratike janë të nevojshme që të vazhdojë të zhvillohet në të gjitha nivelet në parti, pra, të krijojë një sistem të ri konsulence përmes së cilit të gjitha politikat strategjike, konceptet programore,

politikat në nivel lokal dhe masat e tjera do të krijohen brenda të gjitha niveleve në parti, me anëtarësim.

Sistemi i vlerave në funksionimin e organizatave komunale dhe riorganizim

LSDM-ja duhet të njihet për njerëz të ndershëm, të realizuar, të përkushtuar dhe të angazhuar, njerëz që janë pjesë e partisë për të kontribuar dhe për tu angazhuar në të gjitha proceset sociale, njerëz me aftësi dhe shprehje profesionale pune dhe pa paragjykime, plotësisht të përkushtuar për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe përmirësimin e shoqërisë. **Procesi i refuzimit të plotë të klientelizmit është padyshim një sfidë** dhe një synim që LSDM-ja duhet të punojë seriozisht për përparimin dhe transformimin e shoqërisë.

Funksionimi i bordeve lokale do të rishikohet tërësisht dhe bazat për funksionalitetin e partisë duhet nisur pikërisht nga këto zgjedhje lokale, bërthamat thelbësore të partisë.

Anëtarët e menaxhmentit më të lartë në kuadër të organizatave komunale do të përfshihen në **debatet politike** që zhvillohen brenda partisë. Gjithashtu, do të përfaqësohen edhe qëndrimet e anëtarëve të organizatave komunale bazë për matjen e efektivitetit dhe efikasitetit të politikave të miratuara nga Qeveria dhe pushtetet vendore. Detyrimi i tyre themelor duhet të jetë fokusi i problemit real të qytetarëve dhe përmirësimi i standardit të jetesës dhe cilësisë së jetës, e jo të kuadrove politike.

Kryesia e partisë do të jetë gjithnjë në koordinim me grupin e deputetëve, zyrtarëve që janë përgjegjës për institucione të caktuara, për monitorim edhe më të detajuar të funksionimit sistematik të organizatave komunale, monitorimin e zbatimit të angazhimeve strategjike të çdo organizate komunale dhe funksionalitetin e organizatave komunale.

SDMM dhe Forumi i Grave

LSDM-ja është e vetmja parti e cila me ndryshimet e fundit në Statut vendosi barazi gjinore brenda në të gjitha strukturat partiake. Gjithashtu, përmes ndryshimit nga dispozitat statutore, përqindja e të rinjve të përfaqësuar brenda organeve partiake është më e lartë në krahasim me të gjitha partitë e tjera. Prandaj, është e nevojshme të krijohet një strategji e cila do të bazohet në përcaktimin e LSDM-së për të qenë parti e cila në organet dhe trupat e saj qeverisëse ka 50 - 50 përfaqësues të femrave dhe meshkujve, nga e cila 33% janë të rinj. Kjo strategji duhet të mbulojë qëllime dhe aktivitete specifike përmes së cilave do të synohet përfshirje, pjesëmarrje dhe rekrutim më i madh i këtyre grupeve të targetuara brenda partisë me qëllim të rritjes së kapacitetit të partisë. Kërkohet qasje e fortë e të rinjve dhe grave në terren me qëllim që të afrohen dhe të angazhohen kapacitete shtesë dhe të përfshihen në të gjitha proceset e mëtejshme.

Riaktivizimi i sistemit qendror të komisioneve të LSDM-së

Riaktivizimi i sistemit qendror të komisioneve të LSDM-së është i domosdoshëm dhe vendimtar sepse është një mekanizëm serioz për angazhimin profesional dhe hapjen e partisë për shumë profesionistë nga fusha dhe segmente të ndryshme të shoqërisë. Ky sistem i komiteteve do të jetë një mjet kyç në hartimin e politikave për secilën fushë veç e veç, me konsultime të gjera, përmes një procedure standarde që është një analizë gjithëpërfshirëse e çdo politikë në vecanti. Analizë gjithëpërfshirëse me parametra të matshëm përmes së cilave do të përcaktohen efektet e secilës politikë të krijuar rishtazi. Gjithashtu, ky sistem do të jetë vlerë shtesë në pjesën e rinovimit, rekrutimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit me ide të qarta dhe të hapura për reforma në të gjitha fushat dhe gatishmëri në çdo moment për të marrë përgjegjësi.

Ne duhet ta rindërtojmë plotësisht sistemin e konsultimit ndërmjet institucioneve dhe partisë. Jashtëzakonisht e rëndësishme është që ky segment të kujdeset për vijën që ndan partinë dhe shtetin. Sistemi i konsultimit do të shërbejë për efektivitet dhe efikasitet më të madh në zbatimin e politikave, matjes efektive dhe efikase të të gjithë bartësve të funksioneve publike, si dhe monitorim të realizimit të programeve të LSDM-së (qeverisja qendrore dhe lokale). Partia do të krijojë një POS (Protokol Operativ të Standardizuar të komunikimit dhe koordinimit me legjislativin) (Parlamenti dhe grupi parlamentar), me pushtetin ekzekutiv (Qeveria si institucion qendror ekzekutiv, por edhe me të gjithë ministrinë dhe secilin departament veçmas), me pushtetin lokal (BNJVL, vetëqeverisjet lokale dhe secilin nga kryetarët e komunave të zgjedhur nga radhët e LSDM-së).

Zhvillimi i një programi të specializuar për profesionalizmin e kuadrove

Me ndihmën e partnerëve të saj ndërkombëtarë, partive simotra, instituteve dhe organizatave që merren ose kanë programe të ngjashme, LSDM-ja do të krijojë një program të specializuar për zhvillimin e kuadrove, për krijimin e politikave dhe gjithëpërfshirjen.

Në të njëjtën kohë, LSDM-ja mbetet e përkushtuar për forcimin, pajisjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të shërbimeve profesionale të partisë, Qendrës Analitike dhe Qendrës për komunikim me publikun e LSDM-së në përputhje me trendet dhe nevojat moderne të partisë.

2. EKONOMIA NË RRRITJE

PËRMIRËSIMI I STANDARDIT EKONOMIK TË QYTETARËVE

Prioritet i Qeverisë duhet të jetë politika e brendshme, zbatimi i projekteve dhe përmirësimi i standardit ekonomik të qytetarëve, sigurimi i një menaxhmenti profesional përmes së cilit stafi adekuat profesional ndërmerr detyra dhe përgjegjësi të duhura dhe të përcaktuara qartë. Ky është investimi ynë.

Para së gjithash, të përmirësojmë standardin ekonomik të qytetarëve. Ekipet profesionale do të angazhohen me krijimin e masave efektive të mbrojtjes së energjisë si krizë e afërt. Duke qenë se pandemia ende vazhdon, politikat do të jenë të orientuara në mbështetjen e sistemit shëndetësor dhe mbrojtjen e plotë të shëndetit të qytetarëve, ndihmën ekonomike dhe sociale për të gjithë ata që do të kenë nevojë.

Angazhimi i stafit profesional, kompetent, të përkushtuar dhe të përgjegjshëm në të gjitha pozicionet do të sjellë një ndryshim serioz dhe do të rikthejë e rrisë besimin e qytetarëve tek institucionet dhe kjo do të thotë se ne si shtet mundemi të kemi sukses.

Koncepti ekonomik socialdemokrat që është zbatuar në të kaluarën për katër vite me radhë, kthimi i parave tek qytetarët, rritja e pagave, asistenca sociale, pensionet, mbështetja për aktivitetin e brendshëm ekonomik, rritja ekonomike dhe investimet do të vazhdojnë me **dinamikë edhe më të fortë dhe më efikase.**

Baza e të gjitha politikave dhe masave ekonomike për ne është njeriu, kapitali njerëzor, investimi te njerëzit dhe standardi ekonomik i qytetarëve për të cilin kemi plan real dhe të arritshëm për rritje të përshpejtuar ekonomike në periudhën 2022-2026.

Paga minimale në vitin 2017 ishte 9.000 denarë, sot është 15.200 denarë, gjegjësisht Qeveria e udhëhequr nga LSDM-ja e ka rritur për mbi 6.000 denarë. çdo muaj 6000 denarë më shumë janë në xhepin e punëtorit, të secilit që punon shumë, a është paguar shumë pak.

Rritja e pagës minimale duhet të vazhdojë, fillimisht në 18 mijë denarë. Puna e punëtorit duhet vlerësuar sidomos në kohë krize dhe rritje të mundshme të çmimeve. Qëndrimi ynë ndaj avancimit të standardit ekonomik të qytetarëve me të ardhura më të ulëta është i ndershëm dhe realisht i arritshëm. Përmes procesit gjithëpërfshirës me përfshirjen e të gjithëve, sindikatave, odave, do të dalim me zgjidhje të pranueshme për të gjithë. Mesazhi ynë është i qartë, punëtorë, puna juaj vlerësohet, ne jemi këtu për ju sepse paga minimale do të vazhdojë të rritet.

Pagën mesatare në vitin 2017 e gjetëm prej 23.850 denarë dhe në shtator sivjet është 28.869 denarë. Për katër vite politikat ekonomike të qeverisë së udhëhequr nga LSDM-ja rritën pagën mesatare për mbi 5000 denarë. Pothuajse në të gjitha sektorët ka rritje në paga, në

shëndetësi, në arsim, industri, tek mbrojtja sociale dhe fëmijët, në sektorin e mbrojtjes, polici.

Në një kohë kur rritja e çmimeve është e mundur, ne kemi njohuri dhe kemi një plan të qëndrueshëm dhe të arritshëm se si **të përshpejtojmë dhe të rrisim rritjen e pagave**. Rritja e pagës ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e standardit të jetesës së qytetarëve dhe stimulon aktivitetin ekonomik, produktivitetin e punës dhe konkurrencën.

Këtu është fokusi ynë, me të gjitha masat dhe politikat e tjera ekonomike, rritja kumulative e produktivitetit të punës të arrijë në 15% për të mundur rritje reale të pagës neto në të gjithë ekonominë me 11.4%.

Kjo nënkupton **rritje të pagës mesatare për mbi 3,100 denarë** ose 50 euro më shumë në baza mujore. Ne projektojmë realisht qëllimin përfundimtar deri në fund të mandatit me **pagë mesatare prej 34,000 denarë**.

Pagat do të vazhdojnë të rriten në të gjithë sektorët, ashtu si edhe pensionet. Pensioni mesatar sot është pothuajse 2,000 denarë më i lartë në krahasim me vitin 2017, por kjo nuk mjafton. Ata që kanë investuar me punën e tyre në këtë vend, duhet të shijojnë ditë të qeta pensionimi për të pasur për çdo ditë, si dhe për nipërit e mbesat e tyre.

Çdo Janar dhe çdo Korrik të vitit **pensionet do të rriten nga 400 deri në 600 denarë** në varësi të masës së pensionit specifik. Kjo mundësi jep metodologjinë e re të rregullimit të masës së pensioneve sipas kostos së jetesës dhe pagës mesatare.

Papunësia ka rënë në nivelin më të ulët historik prej 15.9%, kemi mbi 50,000 vende të reja pune të krijuara në katër vitet e fundit. Nëpërmjet Planit të Përshpejtuar Ekonomik, ne po njoftojmë **uljen e papunësisë në një shifër njëshifrore prej 8%**.

Mbështetja financiare për të gjithë qytetarët dhe kompanitë do të vazhdojë të rritet. Sic edhe do të krijohen masat e ndërhyrjes në lidhje me krizën energjetike, kujdesi shëndetësor dhe ndihma në kushte pandemie, kështu do të modelohet edhe mbështetja e përforcuar financiare.

Plani për rritje të përshpejtuar ekonomike 2022-2026

Ne kemi një qëllim ambicioz, por **të arritshëm për rimëkëmbjen dhe përshpejtimin ekonomik**. Jemi të fokusuar në arritjen e normave ekonomike dyfish më të larta, përfitimet e së cilës do t'i ndejnë shumë më tepër qytetarët, gjë që do të përfitojnë ata të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Me pak fjalë, qëllimet e këtij plani janë:

- Dyfishim i rritjes ekonomike në krahasim me periudhën paraprake.
- ✓ Investime në sektorin publik dhe aktivizim të investimeve nga sektori privat.

- ✓ Vende të reja të punës me paga të mira.
- ✓ Ruajtja dhe qëndrueshmëria e borxhit publik si dhe reduktimi i tij.
- ✓ Ulja e papunësisë nën 10%.

Arritja e këtyre synimeve përkthehet në një ekonomi të avancuar, të fortë dhe të përshtatur të ekonomive evropiane, duke punuar për qytetarët, për kompanitë, për të gjithë.

Nëpërmjet një kombinimi të mënyrave të reja, inovative dhe tradicionale të financimit dhe zbatimit, ne do të angazhohemi veçanërisht në përmirësimin e jetës së qytetarëve, rritjen dhe zhvillimin ekonomik në fushat e mëposhtme:

- Ekonomia e gjelbër;
- Digjitalizimi;
- Inovacioni dhe zhvillimi teknologjik;
- Kapitali njerëzor;
- Infrastruktura;
- Kohezioni social.

Nën aktivizmin e ri, ekologjia dhe tranzicioni i gjelbër, për herë të parë do të emetohen **obligacione të gjelbra**. Rritje e fondeve për përmirësimin e efikasitetit energjetik, reduktimin e ndotjes, lehtësimin e menaxhimit të mbetjeve, mbështetje për bujqësinë e qëndrueshme dhe shumë projekte të tjera të nevojshme për mjedisin.

Në Bankën për Zhvillim do të krijohet **Fond për Efikasitetin e Energjive** ku ndër të tjerash do të përdoret për financimin e investimeve për efikasitetin e energjisë dhe energjin e rinovueshme në ndërtesat publike.

Do të krijohet **“Fond i Investimeve të Gjelbëra”** si fond i posaçëm në mbështetje të investimeve në ndërmarrje të mëdha dhe infrastrukturën në sektorëprioritarë të Marrëveshjes evropiane të gjelbër.

Plan investimi

Plotësisht përfaqësoj dhe mbështes fuqishëm Planin e Investimeve të Qeverisë. Plani përmban investime publike dhe private të cilat janë në përputhje me strategjitë aktuale dhe të ardhshme për rritjen ekonomike të vendit. Investimet në energjetikë, rrugë dhe infrastruktura hekurudhore; industria përpunuese, zhvillimi i shitjes me pakicë, investime në shëndetin publik, në infrastrukturën komunale – mjedis (impiantet e trajtimit, përzgjedhja e mbetjeve etj.) dhe në turizëm.

Ka shumë projekte nga ky plan, por i theksoj disa dhe i konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishme për sa i përket sfidave energjetike dhe asaj që vijon si zhvillim i një ekonomie tashmë në lëvizje:

Investimi i huaj gjerman më i madhi deri tani, për ndërtimin e një impianti me erë do të prodhojë 400 megavat energji të gjelbër.

Projekte për termocentrale fotovoltaike, investim vetanak i shtetit, nga të cilët 2 me 10 megavat në REK Manastir, në Makedonski Brod, në Sveti Nikollë, në Koçan, në Rajonin e Negotinës, në Bërvenicë dhe lokacione të tjera, me kapacitet 60 megavat.

Investimi francez në lokacionin e aeroportit të planifikuar më parë në Shtip prej 477 hektarësh, ku do të ndërtohet një termocentral fotovoltaike, një nga më të mëdhenjtë në Ballkan.

Projekti ndërkombëtar Alexandroupoli në të cilin ne si shtet kemi një pjesë, termocentralin 800 megavat dhe terminalin e gazit natyror.

Po hyjmë në fazën e dytë të “Chebren”-it historik, një investim i ESM-së si partneriteti Publik Privat. Qendra Klinike në Gjorçe Petrov, Qendra e Skijimit Kodra e Diellit, impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Shkup, impianti seleksionues dhe përpunimi i mbetjeve në rajonin lindor dhe verilindor. Ndërtimi i kolektorëve për trajtimin e ujrave të zeza në Manastir, kolektori i ujërave të zeza në Kërçovë. Ndërtimi i rezervuarëve, diga Reçan Koçan, Raven Reçicë Gostivar, Konjsko Gjevgjeli, diga Sllupçan, akumulimi Shtip. Projekti i Luginës së Vardarit, Rrjeti i ngrohjes për Manastiri, Novaci dhe Mogilla, Hekurudha nga Kumanova deri në kufi me Bullgarinë. Bëhet fjalë për projekte investimi, realizimi i të cilave ka një ndikim pozitiv në rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

Këtu përfshihen edhe ndërtimet dhe rikonstruksionet e të gjitha projekteve të planifikuara dhe të filluara si autostrada, rrugë ekspres dhe rajonale, si dhe gazsjellësi nacional.

Planifikimi vazhdon me ritëm më të fortë. Fokusi im, i ynë, do të jetë tek realizimi me afate dhe përgjegjësi specifike në rast dështimi. Ky është ndryshimi të cilin qytetarët do ta shohin. Kjo do të thotë hap i ri, efikasitet më i madh. Ngritje e shkallës dhe shpejtësi e realizimit të investimeve kapitale, projekteve dhe reformave. Përshpejtim i ndjeshëm i të gjitha proceseve.

3. MENAXHIM EFIKAS DHE ME PËRGJEGJËSI

NJOHURI, EFIKASITET DHE MUNDËSI E DREJTË, KY ËSHTË SISTEMI YNË

Ne mund ta bëjmë Maqedoninë e Veriut një vend të mundësive, një vend në të cilin njerëz me dije, me ekspertizë, me përkushtim, do ta kenë fjalën e fundit në fushën e vet. Kemi njohuri, kemi potencial. Nëse mund të krijojmë produkte me cilësi të lartë që përfundojnë në tregjet më selektive botërore dhe evropiane, ne vetë mund të bëjmë shumë.

Prandaj, shpall emërimin e njerëzve të aftë dhe profesionistë në postet kyçe, plotësisht të përkushtuar ndaj punës dhe cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe ndaj shtetit. Kërkoj angazhimin e të rinjve, por edhe aktivizimin e disave ekspertëve me përvojë, profesionist dhe kompetent. Do ta rrethojmë politikën me ekspertë të çdo niveli, vendas dhe të huaj sipas nevojës. Kur politika është e rrethuar dhe e ndërthurur me ekspertizën, atëherë ajo rritet në menaxhim dhe rezultat konkret për qytetarët. Kjo është ideja bazë e misionit tim reformues.

Arsimi është shumë i rëndësishëm **dhe theks të veçantë do të vëmë në procesin arsimor.** Sepse edukimi formon fëmijët tanë, formon të ardhmen tonë, por edhe të tashmen tonë. Nëse duam ndryshim të vërtetë në shoqëri, ai duhet të fillojë nga më e rëndësishmja, arsimi. Përveç kësaj, të gjitha çështjet madhore dhe të rëndësishme në arsim, të gjitha reformat duhet të kryhen përmes një procesi të gjerë, gjithëpërfshirës të të gjithë akterëve, studentëve, gjimnazistëve, mësuesve, profesorëve, prindërve, që të gjithë. **Reforma në edukim, po, tani dhe menjëherë, por jo me forcë, por me debat, me konsultim, me ofrim të më shumë opsioneve, duke parë shembujt dhe rekomandimet pozitive, së bashku,** me vullnet dhe përkushtim për një të sotme më të mirë dhe një të nesërme më të mirë.

Sistemi ynë duhet të bëhet gjithëpërfshirës, shumë më i shpejtë dhe të gjenerojë njohuri. Dhe e gjithë kjo të pranohet, si një interes i lartë publik.

Fokus i ekspertizës në secilën politikë. Për shembull, kur bëhet fjalë për krizën energjetike, ne po ndërtojmë një ekip të krizës energjetike me ekspertë të fushës, jo politikanë.

Ne do të krijojmë ekipe dhe këshilltarë që do të jenë në gjendje të veprojnë dhe t'i përfaqësojnë temat në mënyrë profesionale para qytetarëve, publikisht dhe jo politikisht. Ne nuk kemi nevojë për "ndjekës të verbër" të cilët me çdo kusht do të mbrojnë LSDM-në edhe kur situata është e pambrojtur, por persona me autoritet, besueshmëri dhe njohuri që do të mbrojnë interesat e qytetarëve dhe të cilët do të japin maksimumin nga vetja dhe do të kërkojnë po të njëjtën nga të tjerët në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Kjo do të thotë një mundësi e drejtë dhe ndonjëherë edhe një avantazh dhe detyrim i profesionistit, njeriut të arsimuar, të zellshëm, të provuar, të pakorruptueshëm, me përvojë, në vendin e duhur. Kjo do të thotë një sistem që ofron, në mënyrë efikase dhe në kohë, një sistem që gjeneron sjellje të përgjegjshme dhe thërret për përgjegjësi nëse dështon. Një sistem që shërben, në mënyrë efikase, të shpejtë dhe me cilësi të barabartë për të gjithë.

Për mua, "dora e fortë" nuk do të thotë dhe nuk mund të thotë kthim në praktikën e vjetra duke shkelur njerëzit. Jo, nëse duam të flasim për një "dorë të fortë", atëherë ajo vërtetë duhet të vlejë, atë edhe e paralajmëroj, menaxhim dhe përgjegjësi dhe **përgjegjësi për mosrealizim** ose punë kundër intereseve publike. Disa e quajnë atë qasje teknokratike, por në thelb ajo nënkupton një sistem të qartë merite që mban përgjegjësi.

Fokusi i qeverisë, retorika dhe komunikimi do të ndryshojnë. Unë nuk do të flas apo t'ju bind për transparencën, sepse ajo është detyrim ligjor, nuk është projekt **por detyrë, detyrim i obligueshëm**. Nuk do të flasim për drejtësi, është detyrë dhe detyrim ligjor, **por do të kërkojmë përgjegjësi nga ata që e shkelin**. Nuk do të flasim vetëm për BE-në dhe të ardhmen si zgjidhja e vetme për njerëzit, por po punojmë në zgjidhjen e problemeve në shtëpi me njohuritë dhe aftësitë tona. Ne nuk do të flasim për atë se cka është obligim i zyrtarëve, por ne do ta bëjmë atë. Ajo se për çfarë do të flasim janë nevojat e qytetarëve, populli tonë dhe mënyrat për të qenë më të shpejtë dhe më cilësor për të plotësuar nevojat e qytetarëve, sepse në thelb kjo do të thotë një jetë më e mirë.

Prania e njerëzve kyç do të jetë në terren, me qytetarët, me punëtorët, me investitorët, më pak në zyrë. Fokusi do të jetë tek ekonomia, tek projektet konkrete dhe zgjidhjet.

Për sa i përket politikës ndërkombëtare, pozicioni strategjik mbetet i njëjtë, pozicioni i cili është i pandryshuar, me vendime të Kuvendit dhe në përputhje me qëndrimin e shumicës dërrmuese të qytetarëve. Retorika jonë kombëtare do të jetë e përgjegjshme, demokratike, e hapur, e gjerë, por mbi të gjitha dinjitoze. Populli, qytetarët e Maqedonisë së Veriut janë dinjitoz dhe ne duhet të komunikojmë në emër të tyre. Nuk mund të presim një tjetër për të zgjidhur problemet tona. Ne jemi një shtet sovran, anëtar i NATO-s që është i sigurt, i fort dhe duhet të ketë një qeveri që duhet mbi të gjitha t'i zgjidhë problemet në vend.

Bëmë gjithçka që duhej, plotësuam kushtet për të filluar negociatat me BE-në, përipiqemi për integrim të plotë në Bashkimin Evropian dhe kjo do të bëhet. Por kjo nuk duhet të jetë bileta jonë e vetme drejt suksesit. Prioritet duhet t'i jepet politikës së brendshme, zbatimit dhe përmirësimit të projekteve ekonomike duke punuar me profesionistë që dinë ta bëjnë këtë.

Teknologjitë e reja, digjitalizimi, agjenda e gjelbër, drejtësia, fokusi në nevojat e qytetarëve.

Sepse një sistem demokratik mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse ka: sistem të përshtatshëm meritash, njerëz kompetentë në vendet e duhura, përgjegjësi dhe drejtësi.

Të nderuar socialdemokratë, shoqe dhe shokë,

Ju ftoj, secilin prej jush, të angazhohemi për një të ardhme më të mirë, të bashkohemi rreth vizionit socialdemokrat, për të punuar për një ekonomi më të mirë dhe një jetë më të mirë të të gjithë qytetarëve dhe punë efikase në interes të popullit dhe shtetit.

Ju bëj thirrje që të më përkrahni në zgjedhjet për kryetar të LSDM-së dhe në atë mënyrë të bëheni pjesëmarrës aktiv në konceptin **“Të gjithë ne bashkë”**, sepse është një hap i ri që LSDM-së i sjell fitoren në zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe presidenciale.

Rroftë LSDM-ja,

Të rrojnë qytetarët

Rroftë Republika e Maqedonisë së Veriut!

Shkup, 01.12.2021

Kandidat për kryetar të LSDM-së
Dimitar Kovačevski

